



## SUCCESS STORY

### *Kërpudhat e vogla nënkuptojnë biznes të madh për Ndërmarrësin Kosovar*

#### Studenti përfiton nga prodhimi i kërpudhave shiitake



Miloš Grujić tregon substratet shiitake në dhomën e inokulimit

“Nuk është e lehtë të studiojë, të ndjekë mësimet, dhe të kujdesem për shiitake, por unë jam duke u përpjekur shumë dhe dua që të arrijë sukses,” thotë Grujić.

Kërpudhat shiitake janë përdorur për mjekime herbale nga kinezët për shumë shekuj. Kjo kërpudhë nga Azia Lindore është përdorur në trajtimin e qarkullimit të gjakut dhe sëmundjeve respiratore por edhe problemet me plakjen e hershme. Karakteristikat e saj promovuese dhe shija e pasur e bëri këtë delikatesë kërpudhën e dytë e ngrënëshme e cila më së shumti kultivohet në botë.

Milosh Grujić, një student i ri i inxhinierisë civile nga fshati Zupçë në Zubin Potok kuptoi për shiitake ndërsa kërkonte në internet dhe kërkonte ide për një lloj të biznesit. Një ndërmarrës i ri në një vend ku papunësia është e lartë, Grujić nuk dëshiroi që puna ta gjejë atë. Pasi u informua tërësisht se si të kultivojë shiitake, ai zhvilloi një plan biznesi dhe iu afrua Programit për Nismën e Veprimtari në Komunitete të USAID-it, duke kërkuar pajisjet e nevojshme për të filluar biznesin e tij.

USAID-i i mundësoi Grujić-it një grant prej \$9,000 në Mars 2013, të cilit ia shtoi \$1,700 nga investimet vetanake për të blerë substrate, sipërfaqe në të cilën rriten kërpudhat, farat shiitake, dhe pajisjet e nevojshme për biznesin e tij.

“Është shumë e vështirë për të rinjtë të gjejnë një punë sot, andaj ky grant do të thotë shumë për mua,” spjegon Grujić. “Nuk është e lehtë të studiojë, të ndjekë mësimet, dhe të kujdesem për shiitake, por unë jam duke u përpjekur shumë dhe dua që të arrijë sukses.”

Kërpudhat kërkojnë kujdes të vecantë andaj Grujić shrytëzoi pak nga mjetet e toj për të punësuar një punëtor i cili kujdeset për kërpudhat kur Grujić është në mësim. Aktualisht, ai kultivon shiitake në një dhomë inokulimi, ku ai ka rreth 500 substrate të cilat i mundësojnë atij të fitojë nga \$6 në \$9 për substrat.

“Kam pasur shumë sukses në shitjen e shiitakes nëpër markete dhe së shpejti do të zgjeroj biznesin për të kultivuar rreth 1,500 substrate,” shpjegon Grujić i cili planifikon të shtojë një dhomë të re të inokulimit posa të plotësoi të paren.

Grujić nuk ka nevojë të kërkojë motivim. “Biznesi me shiitake më ka mundësuar r fitim prej \$750 në muaj, të cilat janë të mjaftueshme për familjen time,” thotë ai.

Programi i Nismës për Komunitete i USAID-it i zhvillohet prej korrikut 2010 deri në korrik 2014. Ky program mbështet zhvillimin e komuniteteve dhe rehabilitimin e infrastrukturës në 40 komunitete të Kosovës, ndërton organizata të fuqishme të shoqërisë civile, si dhe përmirëson gjendjen ekonomike dhe shanset për punësim.